



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**A nr. 442/ 2010**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) me seli në Prishtinë, për shkak të mosfunksionimit prej dhe të baterive fluroscente, në seancën e panelit të mbajtur me 13.12.2010, mori këtë:

## **V E N D I M**

**Hidhet** poshtë ankesa si e palejuar e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV).

## **A r s y e t i m**

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 12.12.2010, nga subjekti politik LVV, me të cilën pretendohet se nuk ka funksionuar prej dhe baterit fluroscente në qendrat e votimit në Mitrovicë, në këto vende:

- Shkolla fillore “Migjeni” - Ilirida
- Shkolla fillore “Abdullah Shabani” – Ilirida
- Shkolla fillore “Vazli Grajqevci” – Shipol
- Shkolla fillore “Shaban Idrizi” – Zhabar
- Shkolla fillore “Skëndërbeu” – Vaganicë
- Rruga “Sami Frashëri” 57 lagjja e boshnjakëve Shkolla Fillore “Hivzi Sylejmani” – Kodra e Minatorëve
- Shkolla fillore “Anton Zako Çajupi” – Qendër
- Shkolla fillore “Bedri Gjinaj” – Sitnicë
- Shkolla fillore “Aziz Sylejmani” – Kqiq
- Shkolla fillore “Bajram Curri” – Gushavcë
- Shkolla fillore “Bajram Curri” – Vidomeriçë
- Shkolla fillore “Minatorët” – Rahovë
- Shkolla fillore “Mehë Uka” – Bajgorë
- Shkolla fillore “Jusuf Rexha” – Kushtovë
- Shkolla “Bujqësore” – lagjja e romëve
- Shkolla fillore “Bislim Hajdari” – Kaqandollë
- Shkolla fillore “Habib Jusufi” – Vllahi
- Shkolla fillore “Rifat Vjolishiqi” – Bare
- Shkolla fillore “Elena Gjika” – Tuneli i parë

- Shkolla fillore “1 Maji” – Shufkocvë
- Shkolla fillore “Sefedin Smakaj” – Rashanë
- Shkolla fillore “Vazli Grajqevci” – Verbnicë
- Shkolla fillore “Trepça” - Melenicë
- posterat e subjektit politik AAK, kane qenë të vendosur në hyrjet te shkollave “Yll Morina” dhe Mazllum Pushka” në Gjakovë, që është në kundërshtim me nenin 36 paragrafi 1 pika (a) dhe (b) te LZP-së.

Parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë.

Neni 59 paragrafi 2 i LZP-së, parasheh:

*59.2 KQZ-ja e Kosovës siguron përgatitjen dhe mbajtjen e zgjedhjeve në pajtim me parimet dhe kërkesat e këtij ligji.*

### **Përgjegjësit dhe Funkcionet e KQZ-së**

Neni 64 i LZP-së parasheh:

*64.1 KQZ-ja është përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji.*

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 6 paragrafi 4 parasheh:

*Panelet vendim-marrëse mund ta refuzojnë me procedurë të shpejtë ankesën apo një grumbull ankesash, të cilat nuk janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore apo ato të cilat sipas mendimit të tyre nuk paraqesin një rast prima facie .*

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se;

#### **- ankesa është e palejuar.**

Pretendimet nga parashtruesi i ankesës, se janë bërë shkeljet e theksuara në ankesë nuk janë nën juridiksionin e PZAP-it, duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e cituara ligjore, në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 442/2010 më datën 13.12.2010.

